



PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, Kryetarja e DHSK-së, Ekaterina Trendafilova më 7 shkurt caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me apelin e z. Mustafa kundër aktgjyqimit të shqiptuar më 16 dhjetor 2022. Afati që Mbrojtja të dorëzojë dosjen e apelit është 6 prilli. Paneli i Gjykatës së Apelit përbëhet nga gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, Kryetarja e DHSK-së, më 3 shkurt, caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi apelin e ndërmjetëm të dorëzuar nga Mbrojtësi i viktimave të cilave u është refuzuar kërkesa për pjesëmarrje, kundër Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave nga Gjykatësi të Procedurës Paraprake, i datës 12 dhjetor, me të cilin rrëzoi një numër kërkesash të personave që dëshironin të pranoheshin si viktime pjesëmarrëse në proces.

Bazuar në Rregullore, personat që dorëzojnë kërkesë për të marrë pjesë në proces si viktime pjesëmarrëse dhe u është rrëzuar kërkesa, kanë të drejtë ta apelojnë vendimin. Paneli i Gjykatës së Apelit përbëhet nga gjykatësit Mishelë Pikar, Emilio Gati dhe Kai Ambos. Paneli miratoi kërkesën e Mbrojtësit për zgjatjen e afatit për dorëzimin e apelit të përbashkët për të gjithë grupin e personave që u është refuzuar kërkesa, pasi kjo do ta përshpejtonte procesin. Paneli caktoi si afat për apelin 15 shkurtin ose shtatë ditë pasi parashtruesit e refuzuar të jenë njoftuar për vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, cilado datë që është e mëvonshme.

Konferenca përgatitore për Prokurorinë në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për datën 15 shkurt, në orën 9:30. Seanca mund të ndiqet nga galeria e publikut të DHSK-së ose përmes faqes së internetit në tri gjuhët e gjykatës, shqipe, serbishte dhe anglishte.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Trupi Gjyqësor, më 6 shkurt, urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Shala. Trupi Gjyqësor konstatoi se rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera vazhdojnë të ekzistojnë. Paneli konstatoi më tej se vetëm nëpërmjet zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHSK-së mund të zvogëlohen mjaftueshëm këto rreziqe. Kur krahasohet me akuzat e rënda kundër të akuzuarit, pamundësinë për të zvogëluar rreziqet jashtë objektit të paraburgimit të DHSK-së dhe duke marrë parasysh se gjykimi fillon më 21 shkurt, Trupi Gjyqësor gjykon se periudha e mbajtjes së të akuzuarit në paraburgim është e arsyeshme.

Deklaratat hyrëse në çështjen gjyqësore *Shala* janë planifikuar për 21 dhe 22 shkurt 2023. Për të ndjekur seancën nga galeria publike nevojitet regjistrim paraprak. Më shumë informacion lidhur me këtë gjendet në

1





faqen e internetit të DHSK-së. Seanca mund të ndiqet edhe përmes faqes së internetit të DHSK-së në tri gjuhët e Gjykatës.

Ndër lajme të tjera: ekipi i Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim i DHSK-së këtë javë organizoi takime me nxënësit e gjimnazit në Prishtinë dhe me shoqërinë civile në Gorazhdevc dhe Lipjan për t'u dhënë informacione të sakta rreth DHSK-së dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe shqetësimeve të tyre.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

